

VENDIM
Nr. 339, datë 19.6.2025

PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE NDAJ TË TRETËVE TË
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për Prodhimin dhe Tregtimin e Armëve, Municioneve, Pajisjeve dhe Teknologjive Ushtarake”, dhe të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj të tretëve, në masën 244 541 460 (dyqind e dyzet e katër milionë e pesëqind e dyzet e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë, të ndërmarrjeve shtetërore Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës Elbasan, Uzina Mekanike Gramsh dhe Kombinati Mekanik Polican, nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, detajuar sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - Efektet financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2025, për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor “Mbështetja e luftimit”.
 - Shlyerja e detyrimeve të prapambetura, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
 - Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1
Detyrime të ndërmarrjeve shtetërore ushtarake

		<i>në lekë</i>
		VLERA
NDERMARRJET SHTETERORE USHTARAKE		
UZINA E LENDEVE PLASESE, MJEKES		64,554,306
UZINA MEKANIKE GRAMSH		2,055,154
KOMBINATI MEKANIK POLICAN		177,932,000
TOTALI DETYRIMEVE		244,541,460